



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: 2-0/DPK  
Nr. Prot: 01-3014/12  
Broj stranica: 02  
Data: 28.08.2012

Republika e Kosovës



Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	28.08.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Hasan Gigolli u.d. Zyrës Prokurimit Policia Kosovës
CC:	z. Shpend Maxhuni Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Kosovës.
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Furnizimi me ushqim për qen"

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Furnizimi me ushqim per qen" me numër prokurimit PK214-12-346-121 ofron këtë:

### OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra e Prokurimit t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

### Arsyetim

Zyra e prokurimit në Policinë e Kosovës ,si autoritet kontraktues, në dosjen e tenderit "Furnizim " të procedurës së hapur dhe titulli i tenderit "Furnizimi me ushqim për qen" me nr. prokurimi PK214-12-346-121 në Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme , faqe 19 dhe 20, Autoriteti Kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartoj specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë Operator Ekonomik.

Autoriteti Kontraktues nuk duhet të përpiloj specifika teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese , lloji ose origjine veçante ose ndonjë prodhim.

Autoriteti Kontraktues mundet që në kushte të jashtëzakonshme, të hartoj specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse Autoriteti kontraktues vërteton se nuk është e mundur që të përpilojë specifikim mjaftë të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatës, me kusht që çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalën “EKUJVALENT”.

Autoriteti Kontraktues me rastin e përgatitjes së specifikave teknike në këtë tender ka dështuar ti përmbahet këtyre rregullave, ngase gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit ka përdorur specifika teknike të cilat drejtpërdrejt janë nxjerr nga një faqe e internetit, të prodhuesit NUTRAM (K9 High Performance for Dogs) nga Kanada, dhe janë të paraqitura në dosje të tenderit. Edhe pas kërkesës nga ana e Operatorëve Ekonomik për informacione shtesë lidhur me specifikat në dosje të tenderit, autoriteti kontraktues nuk e sheh të arsyeshme ti përgjigjet Operatorëve Ekonomik dhe vazhdon të përdor të njëjtat specifika pa bërë ndryshime.

Autoriteti Kontraktues me këtë rast ka përgatitur specifika teknike në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit 04/-L – 42.

Me respekt!

